

VENDIM
Nr. 349, datë 4.6.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 138, DATË 12.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË SHKOLLËS SHQIPTARE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIT E NËPUNËSVE CIVILË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 9 e 69 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, shkronja “g” e pikës 1 të kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“g) Një përfaqësues i shoqërisë civile, i zgjedhur nga ministri përgjegjës për administratën publike, nga radhët e organizatave jofitimprurëse me reputacion. Përvoja e këtij përfaqësuesi në organizatën përkatëse duhet të ketë qenë e lidhur me studime për administratën publike dhe/ose bashkëpunime me të.

Zgjedhja e përfaqësuesit nga shoqëria civile bëhet nga ministri përgjegjës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama